



REPUBLIKA E SHQIPERISE

## KËSHILLI I MINISTRAVE

### PROJEKT VENDIM

PËR

### MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË SHFRYTËZIMIT NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR NGA INDIVIDË APO SUBJEKTE TË LICENSUARA

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr.57/2020, "Për pyjet", me propozim të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Projektvendimi ka për qëllim të përcaktojë procedurat që ndiqen nga individët apo subjektet e licensuara, gjatë kryerjes së veprimtarive të shfrytëzimit në fondin pyor kombëtar.

Neni 2

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", ndërsa termat e mëposhtëm kanë kuptimin si vijon:

1. "Veprimtari shfrytëzuese në fondin pyor kombëtar" janë punimet apo aktivitetet që kryejnë individët për nevojat vetjake apo subjektet e licensuar në fondin pyor, të cilët kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit sipas legjislacionit në fuqi, si më poshtë:
  - a) Punimet për shfrytëzimin e lëndës drusore dhe të asortimenteve;
  - b) Punimet dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore;
  - c) Punimet për prerjet kulturale;
  - d) Punimet për mbrojtjen e tokës pyjore;
  - e) Vlejja dhe grumbullimi i bimëve mjekësore, etetovajore e tanifere natyrore (BMET) dhe prodhimeve pyjore jodrusore;
  - f) Shërbime të tjera në fondin pyor;

2. "Individ" ka kuptimin sipas pikës 22, të nenit 3, të ligjit nr. 57/2020 dhe ndjek procedurat e këtij vendimi vetëm në rastet e shfrytëzimit të fondit pyjor për nevojat e veta.
3. "Subjekt i licensuar", ka kuptimin e personit fizik dhe juridik që ka të drejtë të shfrytëzojë fondin pyjor kombëtar pasi të jetë pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi për licenceat, lejet dhe autorizimet.
4. "Transport i largët", është transporti i lëndës drusore nga sheshet e depozitimit drejt pikës së magazinimit apo shitjes.
5. "Sheshi i depozitimit", ka kuptimin e një vendi të caktuar brenda parcelës ose grup-parcelave të përeaktuara për shfrytëzim, ku depozitohet e stivoset lënda drusore pas përfundimit të transportit të brendshëm.
6. "Punimet për mbrojtjen e tokës pyjore" kanë kuptimin e kryerjes së pyllëzimit dhe të sistemimeve malore.

## KREU II

### PROÇEDURAT E KRYERJES SË VEPRIMTARIVE TË SHFYTËZIMIT

#### Neni 3

##### Procedura e shfrytëzimit të lëndës drusore dhe assortimenteve në fondin pyjor kombëtar

1. Individ apo subjekti i licencuar që zoteron të drejtën e shfrytëzimit i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, projektin teknologjik të shfrytëzimit dhe lejen përkatëse të shfrytëzimit.
2. Struktura përgjegjëse për pyjet, brenda 10 ditëve nga administrimi i kërkesës, pajis me projektin teknologjik dhe lejen e shfrytëzimit individin apo subjektin e licensuar.
3. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, brenda 5 ditëve nga vënia në dispozicion e projektit dhe lejes përkatëse të shfrytëzimit, i dorëzon individit apo subjektit të licencuar parcelën apo parcelat që janë objekt i shfrytëzimit.
4. Pas marrjes në dorëzim, individi apo subjekti i licencuar, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse si dhe në përputhje me asfatet e parashikuara në kontratë, kryejnë procedurat e nevojshme si vijon:
  - a) përforcojnë me shenja të veçanta dhe të kuptueshme drurët e damkosur;
  - b) caktojnë vendet të cilat nevojiten për instalime të përkohshme në funksion të skemave teknologjike të shfrytëzimit, të tillë si skelat e ngarkimit, sheshet e depozitimit, etj.;
  - c) përcaktojnë një vend për ngritjen e campingut të punëtorëve, në rastin kur lëvizja ditore e punëtorëve nga qendra e banuar në vendin e punës dhe anasjelltas, është e pamundur për shkaqe që lidhen me largësinë, etj;
  - d) merr përsipër dorëzimin e vendit të campingut të punëtorëve pas përfundimit të shfrytëzimeve, si në gjendjen fillestare të tij, pa mbetje dhe pa dëmtime;
  - e) brenda periudhës së shfrytëzimit të përcaktuar në lejen e shfrytëzimit, ka detyrimin e mbrojtjes së sipërsfares pyjore në të cilën do të kryhet veprimtaria e lejuar, sipas përcaktimeve në kontratën e përbashkët me pronarin;
5. Në rastin kur në kontratë është përcaktuar që individi apo subjekti i licensuar të kryejë transportin e largët të lëndës drusore, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki pajisjen me vërtetim transporti për përbashkjen e detyrimit kontraktor.

6. Vërtetimi i transportit plotësohet dhe lëshohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki në sheshin e depozitimit, pas kryerjes së matjeve përkatëse të lëndës drusore që do të transportohet.
7. Para kryerjes së transportit të largët të lëndës drusore nga sheshet e depozitimit apo skelat e ngarkimit, individi apo subjekti i licencuar, shënon lëndën drusore me bojë sipas ngjyrës së përcaktuar e të miratuar nga bashkia.

#### **Neni 4**

##### **Procedura për kryerjen e punimeve dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore**

1. Punimet dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore kryhen vetëm nga subjekte të licencuar.
2. Për punimet dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore, subjekti i licencuar, pasi ka lidhur kontraten përkatëse me bashkinë, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në bashki, ndjek procedurën e mëposhtme:
  - a. I kërkon strukturës përgjegjëse në bashki, brenda 5 ditëve, ti dorëzojë subjektit të licencuar projektin përkatës, që do të zbatohet në infrastrukturën pyjore.
  - b. Shënojnë me shenja të qarta në terren, gjurmën mbi të cilën do të zbatohet projekti.
3. Në rast se gjatë zbatimit të projektit cënohet pylli (drurë apo grup drurësh), struktura përgjegjëse për pyjet merr masa për heqjen apo mbrojtjen e tyre.
  - a. Pas verifikimeve në terren, në vendin ku zbatohet projekti, struktura përgjegjëse për pyjet në bashki harton një raport teknik, i cili përmban volumet e lëndës drusore dhe vlerat financiare të saj dhe vijon me heqjen e drurëve.
  - b. Në rast se kostot financiar për heqjen e drurëve nuk janë parashikuar në projektin përkatës, struktura përgjegjëse për pyjet ndjek procedurat për heqjen e drurëve sipas akteve nënligjore në fuqi për pyjet.
  - c. Nëse volumi i drurëve që hiqen është më pak ose e barabartë me  $50 \text{ m}^3$  (metër kub), struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ndjek procedurat për heqjen e tyre dhe brenda 5 ditëve, kryen njoftimin për:
    - i. strukturat përgjegjëse për pyjet në ministri;
    - ii. strukturat përgjegjëse të kontrollit në pyje.
- d. Kur volumi i drurëve që hiqen është më i madh se  $50 \text{ m}^3$  (metër kub), kjo sasi trajtohet nga struktura përgjegjëse për pyjet sipas procedurës së miratimit të mundësisë vjetore të shfrytëzimit.
- e. Pavarësisht procedurave të përcaktuar në gërmën “c” dhe “d”, të pikës 3, të këtij nenit, volumet e hequra janë në përputhje me mundësinë vjetore të shfrytëzimit dhe në asnjë rast ato nuk duhet ta tejkalojnë atë.
4. Në rastin kur, gjatë zbatimit të projektit bëhet i domosdoshëm transporti i largët i lëndës drusore, atëherë subjekti i licensuar i cili është kontraktuar për të kryer transportin e largët të lëndës drusore, kërkon nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, pajisjen me vërtetim transporti.
5. Vërtetimi i transportit, plotësohet dhe lëshohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në sheshin e depozitimit, pasi ka kryer matjet përkatëse të lëndës drusore që do të transportohet.

#### **Neni 5**

##### **Procedura për kryerjen e punimeve për prerjet kulturale**

1. Punimet pér prerjet kulturale kryhen vetém nga subjekti tē licencuar.
2. Pér punimet pér prerjet kulturale, subjekti i licencuar, pasi ka lidhur kontratën pérkatëse me bashkinë, nē bashkëpunim me strukturën përgjegjëse nē bashki, ndjek procedurën e mëposhtme:
  - a. I kérkon, strukturës përgjegjëse tē pyjeve nē bashki që, brenda 5 ditëve nga lidhja e kontratës, ta pajisë me projektin pérkatës pér punimet pér prerjet kulturale dhe lejen pérkatëse pér këtë qëllim.
  - b. Shënojnë me shenja tē qarta nē terren sipërsaqen, mbi tē cilën do tē zbatohen prerjet kulturale, si dhe shënojnë me shenja tē dallueshme tē gjithë drurët që do tē hiqen gjatë prerjeve kulturale.
3. Kur gjatë këtyre punimeve, rezulton tē ketë assortimente tē lëndës drusore tē tillë si lëndë punimi apo dru zjarri, subjekti i licencuar i kérkon strukturës përgjegjëse pér pyjet që tē bëjë vlerësimin e saj, nëse një gjë e tillë nuk ka qenë e parashikuar nē projekt.
4. Në rastin kur, gjatë zbatimit tē projektit bëhet i domosdoshëm transporti i largët i lëndës drusore, atëherë subjekti i licensuar, i cili është kontraktuar pér tē kryer transportin e largët tē lëndës drusore, kérkon nga struktura përgjegjëse pér pyjet nē bashki, që ta pajisë me vërtetim transporti.
5. Vërtetimi i transportit, plotësohet dhe lëshohet nga struktura përgjegjëse pér pyjet nē sheshin e depozitimit, pasi ka kryer matjet pérkatëse tē lëndës drusore që do tē transportohet.
6. Brenda periudhës së përcaktuar nē lejen pér prerjet kulturale, subjekti i licencuar merr përsipër mbrojtjen e tē gjithë sipërsaqes nē tē cilën kryen veprimtarinë e lejuar sipas përcaktimeve nē kontratën e përbashkët me pronarin.
7. Pas përfundimit tē punimeve, subjekti i licencuar i kérkon strukturës përgjegjëse pér pyjet, vlerësimin e punimeve tē kryera dhe dorëzimin e objektit.
8. Struktura përgjegjëse pér pyjet, pas përfundimit tē punimeve, brenda 15 ditësh merr nē dorëzim objektin, duke analizuar, vlerësuar dhe konstatuar mbi bazën e provave administrative, që punimet janë kryer nē përputhje me projektin teknik.
9. Procedura e dorëzimit tē objektit nga ana e subjektit dhe ajo e marries nē dorëzim tē tij nga struktura përgjegjëse pér pyjet, shënohen nē procesverbalin e dorëzimit.

## **Neni 6**

### **Procedura pér kryerjen e punimeve pér mbrojtjen e tokës pyjore**

1. Punimet pér mbrojtjen e tokës pyjore kryhen vetém nga subjekte tē licencuar.
2. Pér punimet pér mbrojtjen e tokës, subjekti i licencuar, pasi ka lidhur kontratën pérkatëse me bashkinë, nē bashkëpunim me strukturën përgjegjëse nē bashki, ndjek procedurën e mëposhtme:
  - a. I kérkon strukturës përgjegjëse pér pyjet nē bashki, që, brenda 5 ditëve nga lidhja e kontratës, ta pajisë me projektin pérkatës pér punimet pér mbrojtjen e tokës pyjore dhe me lejen pérkatëse pér këtë qëllim.
  - b. Struktura përgjegjëse pér pyjet kryen shënjimin e qartë nē terren tē sipërsaqes mbi tē cilën do tē zbatohet projekt.
3. Në rastin e punimeve pér sistemimet malore, struktura përgjegjëse pér pyjet përcakton rrugët pér transportin e lëndëve tē para që nevojiten pér ndërtim, veçanërisht nē rastin kur transporti kryhet me kafshë dhe kalon përmes sipërsaqeve tē pyllëzuara.

4. Pas përfundimit të punimeve, subjekti i licencuar i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet, që të vlerësojë punimet e kryera dhe të dorëzojë objektin.
5. Struktura përgjegjëse për pyjet, pas përfundimit të punimeve, brenda 15 ditësh merr në dorëzim objektin, duke analizuar, vlerësuar dhe konstatuar mbi bazën e provave administrative, që punimet janë kryer në përputhje me projektin teknik.
6. Procedura e dorëzimit të sipërsfaqes pyjore nga subjekti i licencuar dhe ato të marries në dorëzim të tij nga ana e strukturës përgjegjëse për pyjet, shënohen në procesverbalin e dorëzimit.

### Neni 7

#### Procedura për vjeljen dhe grumbullimin e bimëve mjekësore, etetovajore e tanifere natyrore (BMET) dhe prodhimeve pyjore jodrusore

1. Punimet për vjeljen dhe grumbullimi i bimëve mjekësore, etetovajore e tanifere natyrore dhe prodhimeve pyjore jodrusore (këtu e më poshtë BMET), kryhen nga individë apo subjekte të licencuar.
2. Për BMET-t, individi apo subjekti i licencuar, pasi ka lidhur kontraten përkatëse me bashkinë dhe është pajisur me lejen përkatëse, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në bashki, ndjek procedurën e mëposhtme:
  - a. Pajiset nga bashkia brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës me projektin përkatës për vjeljen dhe grumbullimin e BMET-ve dhe prodhimeve pyjore jodrusore dhe me lejen përkatëse.
  - b. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki bën shënjimin e qartë në terren të sipërsfaqes mbi të cilën do të zbatohet projekti.
3. Në rastin kur, gjatë zbatimit të projektit bëhet i domosdoshëm transporti i largët i prodhimeve të dyta, atëherë individi apo subjekti i licencuar kërkon nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, pajisjen me vërtetim transporti.
4. Vërtetimi i transportit, plotësohet dhe lëshohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në vendin e depozitimit, pasi ka kryer vlerësimet përkatëse të BMET-ve dhe prodhimeve pyjore jodrusore që do të transportohen.
5. Brenda periudhës së përcaktuar në lejen përkatëse, subjekti i licencuar merr përsipër mbrojtjen e të gjithë sipërsfaqes në të cilën kryen veprimtarinë e lejuar, sipas përcaktimit në kontraten e përbashkët me pronarin.
6. Pas përfundimit të punimeve, subjekti i licencuar i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet, që të vlerësojë kryerjen e veprimtarisë së BMET-ve dhe të prodhimeve pyjore jodrusore dhe të dorëzojë sipërsfaqen e shfrytëzuar pyjore.
7. Struktura përgjegjëse për pyjet, pas përfundimit të punimeve, brenda 15 ditësh merr në dorëzim objektin, duke analizuar, vlerësuar dhe konstatuar mbi bazën e provave administrative, që punimet janë kryer në përputhje me projektin teknik.
8. Procedura e dorëzimit të sipërsfaqes pyjore nga subjekti i licencuar dhe ato të marries në dorëzim të tij nga ana e strukturës përgjegjëse për pyjet, shënohen në procesverbalin e dorëzimit.
9. Me kërkesë të subjektit, struktura përgjegjëse për pyjet brenda 15 ditëve, lëshon certifikatën e origjinës për BMET-t dhe prodhimet pyjore jodrusore.

### Neni 8

## Dispozita të fundit

- Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe bashkitë përzbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama